



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 89

Tiranë – E premte, 29 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Urban nr. 2, datë 19.5.2015	Për kushtet dhe procedurat për listimin dhe heqjen nga lista e administratorëve të ndërtesave, penalitetet dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre..... 4695
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 22.5.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji..... 4699
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 22.5.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja), sipas interpretimit të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014, si dhe i nenit 32/f të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”..... 4704
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 22.5.2015	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 770, datë 16.4.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë..... 4710
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 22.5.2015	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 71, datë 8.2.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 686, datë 25.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-2236 (433), datë 3.7.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 686, datë 25.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2014-2236 (433), datë 3.7.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 4717
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 22.5.2015	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 238, datë 1.2.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-2523, datë 7.12.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë..... 4723

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 11.5.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4726
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 11.5.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Energal” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4727
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 11.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4728
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 11.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	4728
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 11.5.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencim e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2a” me fuqi të instaluar përkatësisht 1.95 MW; 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).....	4729
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 11.5.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4730
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 11.5.2015	Mbi fillimin e procedurave për kualifikim impianti prodhues si burim i rinovueshëm energjie të shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., për hec “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2a”, përkatësisht me fuqi 1.95 MW, 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).....	4730
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 11.5.2015	Mbi miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE-s, parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.....	4731
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 13.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Kacni”, me fuqi totale 3.87MW.....	4731
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 13.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4732
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 13.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4733
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 13.5.2015	Për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	4733
Kërkesë e Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 959/1, datë 20.5.2015	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.....	4734

**UDHËZIM****Nr. 2, datë 19.5.2015****PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT
PËR LISTIMIN DHE HEQJEN NGA
LISTA E ADMINISTRATORËVE TË
NDËRTESTAVE, PENALITETET DHE
MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË SË
TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 22, pika 1, paragrafi i dytë, dhe nenit 46, pika 2, të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, ministri i Zhvillimit Urban

UDHËZON:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë kërkesat që duhet të përmbushë administratori i ndërtesave të banimit, për listimin në listën e administratorëve të mbajtur nga njësia e qeverisjes vendore, procedurat për listimin dhe heqjen nga lista, penalitetet, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.

Neni 2**Përkufizimet**

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në ligjin nr. 10112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administrator” është administratori, person fizik apo shoqëria administruese, sipas përkufizimeve përkatëse në nenin 2, të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;

b) “Libri i administruesve” është libri që mbahet pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, për regjistrimin e administratorëve që ushtrojnë veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave brenda territorit administrativ përkatës;

c) “Kontratë për administrimin e bashkëpronësisë” është marrëveshja e shkruar, që lidh kryesia, në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve, me administra-torin e ndërtesës;

d) “Strukturë kompetente” do të quhet çdo organizim administrativ, ekzistues ose i ri, që krijohet me vendim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, për të kryer procedurat administrative të regjistrimit apo të heqjes nga libri i administruesve të subjekteve, si dhe propozimin për marrjen e masave disiplinore, siç parashikohet në këtë udhëzim.

KREU II**REGJISTRIMI NË LIBRIN E
ADMINISTRUESVE****Neni 3****Veprimtaria e administrimit**

Veprimtaria e administrimit të ndërtesave për banim mund të kryhet vetëm nga personat e regjistruar në librin e administruesve, të mbajtur nga njësia e qeverisjes vendore në juridiksionin e së cilës ushtrohet kjo veprimtari.

Neni 4**Kushtet për regjistrim në librin e
administruesve**

1. Për t'u regjistruar në librin e administruesve, personat fizikë duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Të kenë moshë madhore dhe zotësi për të vepruar;

b) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

c) Të kenë përfunduar, së paku, arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional;

ç) Të kenë kryer trajnimin profesional fillestar dhe, në vijim, trajnimin e vazhdueshëm vjetor për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, sipas dispozitave të kreut III;

d) Të jenë regjistruar në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa.

2. Kanë të drejtë të regjistrohen në librin e administruesve edhe personat juridikë, që janë të regjistruar në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa, në rast se:



a) kanë të punësuar, së paku, një person me kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm profesional, sipas pikës 1, germa “c” dhe “ç” më sipër, për çdo ndërtesë në administrim; dhe

b) vërtetojnë se ortakët me përgjegjësi të pakufizuar (nëse ka), përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë, si dhe personi apo personat e punësuar për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të bashkëpronësisë plotësojnë kërkesën sipas pikës 1, germa “b”, të këtij neni.

Neni 5

Kërkesa për regjistrim

1. Për t'u regjistruar në librin e administruesve, personi i interesuar duhet të paraqesë kërkesë pranë njësisë së qeverisjes vendore nën juridiksionin territorial të së cilës do të ushtrojë veprimtarinë e administrimit.

2. Kërkesa për regjistrim duhet të shoqërohet nga dokumentacioni që vërteton plotësimin e kushteve për regjistrim, sipas nenit 4 më sipër, në origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin, si vijon:

a) kopje të dokumentit të identifikimit;

b) vërtetim të gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, jo më parë se 3 muaj nga data e kërkesës, ose formularin e vetëdeklarimit;

c) vërtetim të regjistrimit në regjistrin tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, jo më parë se 3 muaj nga data e kërkesës;

ç) diplomë të shkollës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional (niveli 2+1+1);

d) dokument për kryerjen e kursit të trajnimit profesional fillestar për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

dh) vërtetim të autoritetit kompetent se nuk është në proces gjyqësor apo në ndjekje penale.

3. Me marrjen në dorëzim të kërkesës për regjistrim, struktura kompetente pranë njësisë së qeverisjes vendore krijon dosjen personale të personit, fizik apo juridik, në të cilin përfshihen dokumentet e depozituara, si dhe çdo dokument tjetër që depozitohet në vijim në lidhje me veprimtarinë e administratorit, përfshirë kontratat për administrimin e bashkëpronësisë për secilën ndërtesë në administrim.

4. Kërkesat e depozituara regjistrohen në një regjistër të veçantë, sipas datës së dorëzimit. Dokumentacioni ruhet nga kjo strukturë, bazuar në

ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar.

5. Asambleja e bashkëpronarëve mund të kërkojë, si kusht për lidhjen e kontratës së administrimit, që administratori të nënshkruajë një policë sigurimi për mbulimin e dëmeve ndaj të tretëve për gjithë kohën e ushtrimit të detyrës. Në këtë rast, administratori brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës për administrimin e bashkëpronësisë, dorëzon pranë njësisë së qeverisjes vendore edhe kopje të policës së sigurimit të nënshkruar prej tij.

Neni 6

Shqyrtimi i kërkesës

1. Procedurat administrative për regjistrimin e subjekteve në librin e administruesve dhe heqjen prej tij ndiqen nga struktura kompetente në njësinë e qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij udhëzimi.

2. Struktura kompetente për regjistrimin e administratorëve ka të drejtë dhe detyrë funksionale:

a) Të marrë në dorëzim kërkesën me dokumentacionin shoqërues, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për plotësimin e tij;

b) Të shqyrtojë dhe të vlerësojë kërkesat e subjekteve për regjistrim;

c) Të verifikojë ekzistencën e kushteve për regjistrimin e subjekteve dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, gjatë gjithë kohës që subjektet qëndrojnë të regjistruar;

ç) T'i propozojë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore regjistrimin e subjektit në librin e administruesve, në varësi të plotësimit të kritereve dhe të kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim;

d) Përgatit certifikatën e regjistrimit, që vërteton se subjekti është regjistruar si administrator, i cili nënshkruhet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe përmban të dhënat sipas pikës 3 të këtij neni;

dh) Njofton subjektin për miratimin ose refuzimin e regjistrimit;

e) I propozon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore marrjen e masave ndaj subjekteve të regjistruara deri në heqjen nga libri i administruesve, sipas nenit 11 të këtij udhëzimi.

Me miratimin e regjistrimit të subjektit, njësia përkatëse e qeverisjes vendore lëshon certifikatën e regjistrimit, e cila përmban:



Emrin e personit fizik/juridik dhe numrit unik të identifikimit (NUIS);

Mbishkrimin: “Shoqëri administrimi”, ose “Administrator”;

c) Adresën e selisë dhe degëve të mundshme të administratorit;

ç) Emrin e përfaqësuesit ligjor, në rast personi juridik;

d) Datën e regjistrimit të subjektit dhe datën e lëshimit të certifikatës.

4. Struktura kompetente, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës prej subjektit të interesuar, duhet të shprehet zyrtarisht me shkrim për miratimin ose refuzimin e kërkesës së tij për regjistrim.

5. Autoriteti kompetent verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet dhe, nëse vëren mangësi në dokumentacion, kërkon plotësimin e dokumentacionit.

6. Kërkesa e subjektit konsiderohet e dorëzuar nga data e dorëzimit të kërkesës të plotësuar me dokumentacionin e plotë shoqërues, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, sipas nenit 5 më sipër.

7. Në rastin e mosmiratimit të kërkesës për regjistrim, subjektit i lind e drejta e ankimit, sipas dispozitave të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 7

Libri i administruesve

1. Me miratimin e kërkesës për regjistrim, njësia e qeverisjes vendore ka detyrimin të regjistrojë administratorin në librin e administruesve, si person fizik apo juridik, sipas rastit.

2. Për personat juridikë, pasqyrohen në regjistër edhe të dhënat rreth përfaqësuesve ligjorë dhe personave të punësuar për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit, për secilën ndërtesë në administrim.

3. Lista me emrat dhe të dhënat e administratorëve të regjistruar në librin e administruesve përditësohet rregullisht nga njësia e qeverisjes vendore dhe shpallet në vendin e njoftimeve të institucionit, si dhe u njoftohet bashkëpronarëve në ndërtesat përkatëse.

Neni 8

Ndryshime që lidhen me administratorin

1. Administratori ka detyrimin t'i njoftojë njësisë së qeverisjes vendore, brenda 15 ditëve, ndryshime të mundshme sa i përket subjektit apo veprimtarisë së ushtruar prej tij, të tilla si, ndryshime të emërimit të subjektit, të përfaqësuesit ligjor, mbyllje të aktivitetit përkatës etj. Njoftimi duhet të shoqërohet nga dokumentacioni që vërteton këto ndryshime, si dhe përmbushjen e kërkesave sipas nenit 2, në rast se ndryshimi të subjekteve përkatëse.

KREU III

TRAJNIMI PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË ADMINISTRATORIT

Neni 9

Programi i trajnimit dhe autoriteti trajnues

1. Kurrikulat për mësimdhënien në kurset e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, hartohen nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe miratohen nga ministri i Zhvillimit Urban.

2. Trajnimi profesional fillestar dhe i vazhdueshëm i personave për kryerjen e veprimtarisë së administrimit kryhet nga institucionet profesionale të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Dhënia e certifikatës së trajnimit fillestar

1. Pas përfundimit me sukses të testit vlerësues, institucioni trajnues lëshon certifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së administratorit.

2. Institucioni trajnues është i detyruar që t'i përcjellë të dhënat për personat e certifikuar në Ministrinë e Zhvillimit Urban, brenda 15 ditëve nga dhënia e certifikatave.

Neni 11

Trajnimi i vazhdueshëm

1. Për të ushtruar veprimtarinë e administratorit, krahas certifikatës për përfundimin me sukses të trajnimit fillestar, administratori duhet të kryejë rregullisht trajnimin vazhdueshëm që mbahet çdo tre vjet.



KREU IV
MASAT DISIPLINORE DHE HEQJA NGA
LIBRI I ADMINISTRUESVE

Neni 12
Procedimi disiplinor

1. Njësia e qeverisjes vendore, kryesisht ose me kërkesë të çdo të interesuari, fillon procedimin disiplinor ndaj administratorit, kur konstatohen shkelje të legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit ose në rastet kur subjekti ka humbur një ose disa prej kushteve për regjistrimin në librin e administruesve.

2. Brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës ose marrja e vendimit për fillimin e procedimit disiplinor, sipas rastit, struktura përkatëse njofton administratorin me letër rekomande për fillimin e procedurave të heqjes nga lista, si dhe të drejtën e tij për t'u paraqitur për dëgjim pranë strukturës përkatëse.

3. Njoftimi përmban arsyet e fillimit të procedimit disiplinor, si dhe datën e paraqitjes së tij për dëgjim pranë strukturës, datë e cila duhet të caktohet jo më parë se 10 ditë nga data e njoftimit, në mënyrë që administratori të ketë kohë të arsyeshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

4. Seanca dëgjimore e administratorit zhvillohet në prani të përfaqësuesve të strukturës kompetente dhe personit apo organit që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor. Të dyja palët kanë të drejtën e mbrojtjes në seancat e dëgjimit.

5. Struktura kompetente, pas seancës dëgjimore dhe verifikimit të pretendimeve përmes inspektimeve në vend, kur është e nevojshme, propozon mbylljen e procedimit disiplinor ose marrjen e masës disiplinore, në përputhje me masën e shkeljes dhe dëmit të shkaktuar.

Neni 13
Masat disiplinore

1. Masat disiplinore janë:
 - a) paralajmërim me shkrim;
 - b) pezullim i veprimtarisë;
 - c) heqje nga libri i administruesve.

2. Vërejtja me shkrim jepet në rast shkeljesh të lehta, që nuk kanë sjellë dëme të rëndësishme, dhe vetëm në rast se shkelja nuk është e përsëritur.

3. Pezullimi jepet në rast se administratori është në ndjekje penale apo është dënuar me

vendim jo të formës së prerë për një vepër penale sipas pikës 1, germa “b”, të nenit 4, të këtij udhëzimi.

4. Heqja nga libri administratorëve vendoset për shkelje të rënda apo të përsëritura të ligjit, si dhe në rast se administratori humbet njërin nga kushtet që duhet të plotësojë për regjistrim, sipas nenit 4 të këtij udhëzimi.

Neni 14
Përgjegjësitë e administratorit

1. Administratori është përgjegjësi i vetëm për veprimtarinë e administrimit të ndërtesës, për të gjitha dëmet që mund të ketë shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia, si dhe për pasojat e tjera që kanë ardhur apo mund të vijnë për shkak të keqadministrimit të tij, edhe pas heqjes së tij nga libri i administruesve.

2. Në vendimin e heqjes nga libri i administruesve, shënohen edhe detyrimet e këtij subjekti ndaj asamblesë së bashkëpronarëve me të cilën ka lidhur kontratë për administrimin e bashkëpronësisë.

KREU V
MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË SË
ADMINISTRATORIT

Neni 15
Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrja inspektuese mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, kryhet nga struktura kompetente, pranë njësisë së qeverisjes vendore, me iniciativë të vetë ose mbi ankimin e palëve të interesuara.

2. Gjatë kryerjes së punës inspektuese, inspektorët sipas paragrafit 1 të këtij neni, kanë të drejtë të kryejnë inspektime në të gjitha ndërtesat në bashkëpronësi, edhe kryesisht, duke kontrolluar dhe mbikëqyrur respektimin, nga ana e administratorëve, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

3. Asambleja e bashkëpronarëve ose administratori, si dhe pronarët e njësive individuale në ndërtesën në bashkëpronësi ose përfaqësuesit e tyre janë të detyruar t'i mundësojnë inspektorëve akses në dokumentet e



nevojshme, lidhur me administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi.

4. Për gjendjen e konstatuar inspektori mban procesverbal në bazë të të cilit merret vendimi nga struktura kompetente dhe në bazë të të cilit kryhet ekzekutimi.

5. Në rastet kur pretendimet e ngritura nga ankuesit gjenden të bazuara ose kur konstatohen shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, struktura kompetente, pasi njofton administratorin, i propozon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore marrjen e masave ndëshkimore ndaj administratorit, sipas kreut IV të këtij udhëzimi.

Neni 16

Mbikëqyrja administrative

1. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së administratës vendore rreth zbatimit të këtij udhëzimi e bën Ministria e Zhvillimit Urban.

2. Çdo person që pretendon se i janë shkelur të drejtat, si pasojë e një vendimi a mosveprimi të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 15 më sipër, ka të drejtë të ankohej ose të njoftojë Ministrinë dhe të kërkojë ndërhyrjen e saj për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Ministria, pasi kryen verifikimet e rastit, merr vendim lidhur me ankimin si më sipër, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të tij.

3. Pas këtij ankimi, subjekti mund të ankohej në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 17

1. Për periudhën 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, personat fizikë dhe juridikë do të regjistrohen në librin e administruesve, pa plotësuar kushtin e kryerjes së kursit të formimit profesional për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, pasi të kenë plotësuar kushtet dhe kriteret e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Brenda kësaj periudhe, personat fizikë dhe individët e punësuar nga personat juridikë, përgjegjës për administrimin e bashkëpronësisë, duhet të pajisen me certifikatën e kryerjes së kursit profesional. Pas afatit 2-vjeçar, këta persona duhet të aplikojnë për konfirmimin e

regjistrimit në librin e administruesve, sipas nenit 4 të këtij udhëzimi. Në mungesë, administratorët do të hiqen automatikisht nga libri i administruesve.

Neni 18

Udhëzimi nr. 7, datë 1.10.2014, “Për kërkesat që duhet të përmbushë administratori dhe shoqëria e administrimit për t’u listuar në librin e administratorëve, procedura e listimit, heqjes nga lista, penalitetet, procedura për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN

Eglantina Gjermeni

VENDIM

Nr. 25, datë 22.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 26.2.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 5 Akti që i përket:

KËRKUES: Sokol Sheti

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Brendshme, Zyra Përmbartimore Private Anastas Kote

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së



Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi pretendimet e kërkuessit, i cili kërkonte pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Ministria e Brendshme, i cili kërkonte rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar si drejtor i Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Brendshme, nga maji 2007 deri në datën 25 mars 2013.

2. Me shkresën nr. 1570/5, datë 25.3.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme, kërkuessit i është dhënë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil.

3. Mbi bazën e ankimit të kërkuessit, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 100, datë 16.5.2013, ka vendosur shfuqizimin e aktit nr. 1570/5, datë 25.3.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm si të pabazuar në ligj dhe prova; kthimin në vendin e punës në pozicionin e mëparshëm; pagimin e pagës duke filluar nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim është kundërshtuar nga Ministria e Brendshme para Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 72, datë 26.9.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 100, datë 16.5.2013, të Komisionit të Shërbimit Civil.

5. Në datën 14.10.2013 është lëshuar urdhri për ekzekutimin e vendimit nr. 100, datë 16.5.2013, të Komisionit të Shërbimit Civil.

6. Në datën 21.10.2013 nga pala debitore, Ministria e Brendshme, është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili nuk është shqyrtuar ende.

7. Në datën 17.12.2013 pranë zyrës së përmbauesit gjyqësor privat është paraqitur kërkesa e kërkuessit për ekzekutimin e vendimit të mësipërm, mbi bazë të së cilës është bërë lajmërimi i debitorit për ekzekutim vullnetar.

8. Në datën 13.1.2014 përmbauesi ka bërë lajmërimin e debitorit për ekzekutim të detyrueshëm. Kërkesat e përmbauesit për ekzekutim të vendimit janë përsëritur në datat: 13.2.2014, 10.3.2014, 10.4.2014, 2.6.2014 dhe 20.8.2014.

9. Në datën 2.5.2014 është lëshuar urdhri për vendosjen e sekuestros konservative ndaj degës së thesarit Tiranë. Ky urdhër është përsëritur në datën 2.6.2014. Me urdhrin e kryetarit të degës së thesarit Tiranë, datë 14.5.2014, është vendosur bllokimi i fondeve buxhetore të institucionit debitor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të kreditorit Sokol Sheti, në vlerën e detyrimit 1,399,684 lekë. Ky urdhër është përsëritur në datën 11.8.2014.

10. Në lidhje me detyrimin financiar të shlyer kundrejt kreditorit, rezulton nga vërtetimet e sjella prej palës debitore, Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 10524/1, datë 6.1.2015, janë bërë disa pagesa:

10.1 Në datën 20.12.2013 është bërë pagesa prej 195,000.00 lekësh (shpenzime vendime gjyqësore) për llogari të zyrës përmbaimore Anastas Kote, kreditor Sokol Sheti;

10.2 Në datën 18.3.2014 është bërë pagesa prej 88,790.00 lekësh (shpenzime vendime gjyqësore) për llogari të zyrës përmbaimore Anastas Kote, kreditor Sokol Sheti;

10.3 Në datën 3.7.2014 është bërë pagesa prej: 243,029.00 lekësh (shpenzime vendime gjyqësore); pagesë prej 48,040.00 lekësh (taksë përmbaimi) dhe pagesë prej 65,880.00 lekësh (tatim në burim për vendim gjyqësor) për llogari të zyrës përmbaimore Anastas Kote, kreditor Sokol Sheti;

10.4 Në datën 12.12.2014 është bërë pagesa prej 19,764.00 lekësh (sigurim suplementar) dhe 158,695.00 lekësh (sigurim shoqëror shëndetësor për periudhën 25.4.2013-31.10.2013) për llogari të zyrës përmbaimore Anastas Kote, kreditor Sokol Sheti.

11. Në lidhje me kthimin në punë të kërkuessit, me shkresën nr. 8751 prot., datë 27.10.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme është njoftuar Departamenti i Administratës Publike për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Sipas shkresës, kërkuessit Sokol Sheti i është ofruar vendi i punës së Inspektorit në Drejtorinë e



Inspektimit të Përgjithshëm, pasi vendi që ai kishte mbajtur më parë ishte tashmë i zënë. Kërkuesi nuk e ka pranuar vendin e propozuar me arsyetimin se nuk ishte i afërt me pozicionin nga i cili ai ishte larguar padrejtësisht.

II

12. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 100, datë 16.5.2013, të Komisionit të Shërbimit Civil. Kërkuesi pretendon se si shkak i cenimit të së drejtës është sjellja e subjektit të interesuar, Ministrisë së Brendshme, lidhur me mosekzekutimin e detyrimit për rikthimin në punë në vendin që ka mbajtur deri në momentin e largimit padrejtësisht nga puna. Gjithashtu, ai ka kërkuar pagimin e diferencave të pagave të papaguara.

13. **Subjekti i interesuar**, Ministria e Brendshme, ka paraqitur prapësime duke argumentuar:

1.31 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi subjekti i interesuar e ka ekzekutuar detyrimin financiar që kishte ndaj kërkuesit;

13.2 Është plotësuar edhe kushti i kthimit në punë. Kërkuesit i është ofruar një vend pune si inspektor, por ai nuk e ka pranuar. Çështja e rikthimit në detyrë si drejtor i Drejtorisë Juridike nuk është e mundur të realizohet, për shkak të ndryshimit të kriterëve për këtë pozicion pune, të cilat kërkuesi nuk i përmbush.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

14. Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesën për konstatimin e cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, pasi është përmbushur i gjithë detyrimi financiar i caktuar në vendimin gjyqësor, si dhe ofrimi i një vendi pune të përafërt, gjë që nuk është pranuar nga kërkuesi.

15. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi *prima facie* ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Në nenet 131, shkronja “P”, 134

pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, përcaktohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

16. Gjykata Kushtetuese konstaton se në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, i cili është organi kompetent për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

17. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për konstatimin e cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

18. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm



vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkruesore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Vendimi i Gjykatës së Apelit, në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e

fundit vendos pezullimin e vendimit në bazë të nenit 479 të KPC-së (*shih vendimin nr. 56, datë 21.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata çmon se çështja në shqyrtim duhet të vlerësohet lidhur me natyrën e detyrimit që duhej të ishte përmbushur nga subjekti i interesuar. Konkretisht, pagimi i pagës si drejtor i Drejtorisë Juridike gjatë kohës që kërkuarisi nuk ka punuar si i tillë, për shkak të largimit nga detyra, si dhe rikthimi në detyrën që mbante para largimit.

24. Në rastin konkret nuk rezulton se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë apo në fazën e veprimeve përmbarimore. Si i tillë, mund e duhej të ekzekutohej nga pala debitore pa u kushtëzuar nga veprimi i kërkuarit për ekzekutimin nëpërmjet procedurave përmbarimore.

i) Kompleksiteti i çështjes

25. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes Gjykata vëren se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuarit për periudhën e qëndrimit pa punë, pra deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

ii) Sjellja e kërkuarit

26. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para rastit të tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve apo mosveprimeve të kërkuarit, duke sjellë tejkalimin e një afati të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

27. Në çështjen konkrete sjellja e kërkuarit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Rezulton që kërkuarisi jo vetëm nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e tij të plotë.

28. Mbështetur në aktet e paraqitura rezulton se kërkuarisi, në datën 17.12.2013, ka paraqitur kërkesë për ekzekutimin e vendimit, pranë zyrës së përmbaruesit gjyqësor privat, mbi bazë të së cilës është bërë lajmërimi i debitorit për



ekzekutim vullnetar. Në datën 13.1.2014, përmbaruesi ka bërë lajmërimin e debitorit për ekzekutim të detyrueshëm. Kërkesat e përmbaruesit për ekzekutim të vendimit nga pala debitore janë përsëritur në datat: 13.2.2014, 10.3.2014, 10.4.2014, 2.6.2014, 20.8.2014. Nga këto fakte, rezulton se sjellja e kërkuarit nuk ka shkaktuar vonesa, përkundrazi ka ekzistuar interesi i ligjshëm i tij i shoqëruar me veprimet përkatëse, me qëllim realizimin e detyrimit që rrjedh nga një vendim i formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve

29. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëloj (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nga dokumentet bashkëngjitur dosjes rezulton se nga përmbaruesi gjyqësor janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, por që kanë rezultuar të pasuksesshme për sa i takon kthimit në punë të kërkuarit nga ana e palës debitore.

30. Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, është shprehur se është në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuarin në punë. Sipas shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, datë 29.1.2015, rezulton se pak kohë pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Apelit, mbi bazën e urdhrit nr. 190, datë 18.10.2013, të Kryeministrit, Drejtoria ku ka qenë i punësuar kërkuari u reformua duke u quajtur Drejtoria Juridike dhe e Përafrimit të Legjislacionit, gjë e cila ka sjellë dhe ndryshimin e përbërjes sektorale, përshkrimit të punës dhe të kriterëve të rekrutimit të nëpunësve në këtë Drejtori. Për t'u punësuar në këtë Drejtori duhet të plotësohet kushti i pasjes së 3 viteve përvojë pune në fushën e përafrimit të legjislacionit, kriter i cili nuk plotësohet nga kërkuari.

31. Gjithashtu, pala debitore, përveç se e konsideron veten në pamundësi, e quan edhe të realizuar detyrimin që ka ndaj kërkuarit për kthimin në punë. Për këtë qëndrim të saj, ajo parashtron para Gjykatës faktin se i ka ofruar

kërkuarit vendin e specialistit në një sektor tjetër brenda Ministrisë së Brendshme, konkretisht pozicionin e Inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Përgjithshëm. Ky pozicion nuk është pranuar nga kërkuari me arsyetimin se sipas vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, ai duhej të kthehej në vendin e mëparshëm të punës dhe jo në një vend pune që nuk i përafrohet në nivel dhe kategori atij që kishte më parë dhe nga i cili ishte larguar padrejtësisht.

32. Gjykata vëren se pala debitore ka vazhduar me ekzekutimin e detyrimit financiar, i cili rezulton i ekzekutuar në tërësi. Nga parashtrimet e palës debitore rezulton se ajo e konsideron të ekzekutuar plotësisht vendimin në të gjitha pikat e tij.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 dhe nr. 10, datë 1.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata vëren se pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuari nuk plotëson kriteret për të mbajtur vendin e punës, nga i cili kërkuari u largua padrejtësisht, është i pabazuar. Gjykata vëren se detyrimi për kthimin në punë rrjedh nga një vendim gjyqësor. Gjithashtu, kërkuari ka paraqitur disa herë kërkesë pranë Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi. Gjykata vëren se subjekti i interesuar duhej të kishte bërë të gjitha përpjekjet për t'i



ofruar kërkesit një vend të përafërt me atë që ka mbajtur para largimit nga puna, në rast se i njëjti vend pune nuk është më i mundur të ofrohet. Vendi i inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit nuk është i të njëjtit nivel dhe kategori me atë të drejtorit të Drejtorisë Juridike.

35. Gjykata çmon se në lidhje me pagimin e pagës, si pjesë e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë, nuk konstatohet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi subjekti i interesuar ka shprehur vullnet dhe ka shlyer detyrimet për këtë pjesë.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 100, datë 16.5.2013, të Komisionit të Shërbimit Civil, për sa i përket moskthimit në punë të kërkesit.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 26, datë 22.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 12.2.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 71/38 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja), sipas interpretimit të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014, si dhe i nenit 32/f, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d” dhe 145/2, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 68 e 70, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, shqyrtoi kërkesën e gjykatës referuese, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Paditësi ka paraqitur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (Gjykata referuese), me objekt: dëmshpërblim nga i padituri të shumës



10.000 euro për arsye të shkaktimit të dëmit pasuror dhe jopasuror të shëndetit dhe dinjitetit, nga të cilat 7000 euro për dëmin shëndetësor dhe shpirtëror dhe 3000 euro për diskriminimin moral. Kjo gjykatë ka filluar gjykimin e çështjes me paditës T.R. dhe me të paditur R.H. Nisur nga shkaku ligjor i padisë dhe objekti i padisë, mosmarrëveshja, sipas gjykatës, është vlerësuar si mosmarrëveshje e karakterit civil. Thelbi faktik i kësaj padie ka qenë pretendimi për shkak të dëmi për shkak të diskriminimit gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra të palës paditëse nga pala e paditur. Pala paditëse këtë pretendim e ka mbështetur te vendimi nr. 98, datë 9.10.2014, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që e ka konstatuar diskriminimin dhe ka individualizuar si përgjegjëse palën e paditur.

2. Në seancën e datës 29.9.2014, pala e paditur ka vendosur të paraqesë një kundërpadi, nëpërmjet së cilës kundërshton si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm vendimin nr. 98/2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë seancë para gjykatës u shtrua për zgjidhje vendimmarrja e ndërmjetme lidhur me gjykimin e kundërpadisë apo me mungesën e kompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata referuese vërejtë se kundërpadia, në bazë të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përbën lëndë gjykimi administrative, duke e interpretuar atë nga shkaku ligjor dhe objekti.

3. Sipas nenit 55, të Kodit të Procedurës Civile: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar dhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”*. Ndërkohë që gjykata referuese ka evidentuar vendimin unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014 (*vendimi unifikues nr. 3/2014*) mbi këtë dispozitë, sipas të cilit: *“Nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të shqyrtojë këtë kërkim të të paditurit, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatës që po shqyrton padinë. Nëse në një gjykim administrativ paraqitet një kundërpadi e natyrës civile, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të marrë në shqyrtim edhe kundërpadinë, për shkak se i mungon kompetenca lëndore e saj...”*.

4. Në këto kushte, Gjykata referuese, gjendur para bindjes se neni 55 i KPC-së, i interpretuar me vendimin unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014, është antikushtetues, si dhe faktit se moszbatimi i këtij vendimi unifikues do ta penalizonte gjyqtarin e caktuar për shqyrtimin e çështjes, vendosi pezullimin e gjykitimit.

5. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 902, datë 29.9.2014, gjykata referuese i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 55 të KPC-së, të interpretuar me vendim unifikues, sipas të cilit: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar dhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”*, si dhe të nenit 32/f, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, *“Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”*, sipas të cilit: *“...Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit: [...] f) moszbatimi i vendimit unifikues, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave, këto vendime janë të detyrueshme”*.

II

6. Gjykata referuese argumenton se nenet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenet 42, 17 dhe 147/6 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Konkretisht, sipas kësaj gjykate ka shkelje të parimeve/standardeve të mëposhtme:

6.1 Gjykatës së caktuar me ligj, sepse disa çështje mund të bashkohen me njëra-tjetrën për shkak të natyrës juridike të përbashkët të kërtimeve, pavarësisht faktit të lidhjes së thjeshtë ose të ndërvarur apo shkakut ligjor që ato kanë. Për këtë arsye, nenet 55, 57 dhe 159, të KPC-së, *parashikojnë kompetencën për shkak të koneksitetit të çështjeve në një të vetme*. Për shkak të dobisë procedurale të shtuar, gjykata cedon para kompetencës territoriale apo lëndore dhe kumulon çështjet në gjykim në një të vetme. Me vendimin unifikues nr. 3/2014, Gjykata e Lartë ka ndryshuar ligjin dhe nuk e ka interpretuar atë në mënyrë pajtuese me Kushtetutën. Kriteret ligjore të titullimit të një gjykate si një “gjykatë kompetente” nuk janë qëllim në vetvete, por shërbejnë si garanci për elemente të tjera të procesit të rregullt ligjor.



6.2 Ekonomizimit të procesit, sepse çdo reformë ligjore duhet të mbajë parasysh parimin kushtetues të ekonomizimit të procesit gjyqësor në termat e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit. Duke spostuar, ndryshuar apo shuar kompetencën për shkak të koneksitetit para gjykatës civile dhe administrative të padisë civile dhe kundërpadiës administrative dhe e anasjella, cenohet elementi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe sjellja e autoriteteve përkatëse (Gjykata e Lartë/gjykatat) do të ishte shkak i mosrespektimit të këtij standardi.

6.3 Të së drejtës së mbrojtjes, sepse krahas funksionit primar të realizimit gjyqësor të të drejtave subjektive të shkelura të palës së paditur kundërpadiëse, kundërpadia kryen edhe një funksion tjetër procedural dhe gjyqësor, ajo është një ndër strategjitë mbrojtëse të palës së paditur. Në këto kushte, vendimi unifikues nr. 3/2014 i ka hequr palës së paditur të drejtën që të ndikojë në bindjen e brendshme të gjyqtarit me përzgjedhjen e strategjisë mbrojtëse të kundërpadiës.

6.4 Sigurisë juridike, sepse ndarja e koneksitetit të çështjeve mes gjykatave civile dhe administrative krijon kushte faktike për vendime gjyqësore të formës së prerë të paqëndrueshme në kohë. Duke u ndarë çështja në dy gjykata të ndryshme dhe dy gjyqtarë të ndryshëm, ekzistojnë mundësitë që vendimet përfundimtare të kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe sakaq të ushtrohet kërkesa për rishikim nga palët për shkak të dy vendimeve të formës së prerë kontradiktore, sipas pikave “d” ose “e”, të nenit 494, të KPC-së.

6.5 Kufizimeve kushtetuese, pasi cenimi i standardeve: të një gjykate të caktuar me ligj, të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, të së drejtës së mbrojtjes, si dhe të sigurisë juridike nuk ndjek një qëllim apo interes publik, ndërkohë që nuk respekton edhe balancën mes përdorimit të mjeteve dhe justifikimit të qëllimit, duke kualifikuar ruajtjen e institutit procedural të kompetencës lëndore si qëllim dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor si mjet, në kushtet kur duhet të ndodhte e kundërta.

6.6 Pavarësisë së gjyqësorit, pasi ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor” e ka kualifikuar moszbatimin e një vendimi unifikues si shkelje shumë të rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit, duke dalë përtej garancive kushtetuese të mbrojtjes së gjyqtarit, të sanksionuara nga neni 147/6 i

Kushtetutës. Sjelljet dhe aktet që diskreditojnë rëndë figurën e një gjyqtari kushtetues, një gjyqtari të Gjykatës së Lartë apo një funksionari kushtetues duhet të jenë njëloj të kualifikuara edhe për gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit. Moszbatimi i vendimeve unifikuese u faturohet vetëm dy kategorive të gjyqtarëve (shkallës së parë dhe apelit). Koncepti kushtetues i “akteve dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit” është sqaruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, por edhe pa këtë sqarim ky nocion kushtetues është i vetësquarueshëm edhe në mungesë të ligjit detajues. Në këtë kontekst nuk mund të konsiderohet “shkelje shumë e rëndë” moszbatimi i vendimeve unifikuese apo vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, që sipas kodeve të procedurave civile dhe penale janë të detyrueshme për gjykatat.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar se:

7.1 Kërkesa e gjykatës referuese është haptazi e pabazuar, prandaj nuk duhej kaluar në seancë plenare.

7.2 Gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi të gjitha argumentet i orienton mbi cenimin e primeve dhe të standardeve kushtetuese nëpërmjet vendimit unifikues nr. 3/2014.

7.3 Në lidhje me objektin e parë të kërkesës, shfuqizimin e nenit 55 të KPC-së, vetë premisa e gjykatës referuese është që kjo dispozitë është në pajtim me Kushtetutën, prandaj kërkesa nuk ka shkak kundërshtimi juridik.

7.4 Në lidhje me objektin e dytë të kërkesës, shfuqizimin e nenit 32/f, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi kjo dispozitë nuk ka lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete. Neni 32/f nuk është dispozitë procedurale që rregullon procedurën e gjykimit.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, nuk ka paraqitur parashtrime, pavarësisht faktit që është njoftuar me shkresën nr. 71 Akti, datë 18.12.2014.

III

Për legjitimitimin e Gjykatës Referuese

9. Gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nëse plotëson kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe



neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuara nga Gjykata Kushtetuese, por që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, çmojnë se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën.

10. Gjykata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese, gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t’i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014 dhe nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata çmon të shprehet veçmas në lidhje me legjitimitimin e gjykatës referuese, sipas objektit të kërkesës që i përket shfuqizimit të dy dispozitave ligjore të ndryshme, bazuar mbi argumente të ndryshme.

A. Për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 55 të KPC-së sipas interpretimit të vendimit unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014, në lidhje me nenin 42 dhe 17 të Kushtetutës

12. Gjykata vëren se gjykata referuese ka parashtruar pretendime të lidhura kryesisht mbi

cenimin e standardit “gjykatë e caktuar me ligj”, dhe rrjedhimisht të së drejtës së mbrojtjes, të sigurisë juridike dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Kjo gjykatë argumentet e veta i mbështet tek interpretimi i realizuar, me vendim unifikues të nenit 55 të KPC-së. Sipas saj, neni 55 i KPC-së e lejon gjykimin e një padie civile dhe të një kundërpadie administrative nga e njëjta gjykatë (ose *vice – versa*), për shkak të parimit të koneksitetit, por vendimi unifikues e ka devijuar qëllimin e këtij neni, duke mos e mundur gjykimin e një padie së bashku me një kundërpadi, kur në kompetencë lëndore u përkasin gjykatave të ndryshme. Kështu, sipas gjykatës referuese, gjykatë e caktuar me ligj është gjykata që shqyrton padinë nga pikëpamja lëndore dhe kërkimet e tjera për shkak koneksiteti.

13. Gjykata konstaton se gjykata referuese në kërkesën e saj niset nga premisa se neni 55 i KPC-së nuk ka elemente të dyshimta për jokushtetutshmëri, por vendimi unifikues nr. 3/2014 cenon standardet e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se në thelb të kërkesës gjykata referuese ngre pretendime për papajtueshmërinë me parimet dhe standardet kushtetuese të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

14. Gjykata gjen me vend të ritheksojë se sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit. Sipas interpretimit literal që i bëhet kësaj dispozite, çështja e kushtetutshmërisë që i nënshtrohet gjykimit kushtetues gjatë kontrollit incidental ka si objekt një ligj, të cilin gjykata referuese e konsideron si të vesuar nga pikëpamja kushtetuese. Objekt i gjykimit kushtetues, në rastet kur kemi të bëjmë me një kërkesë në rrugë incidentale, është norma, pra rregullimi juridik. Prandaj, gjykata gjykon mbi normën dhe shprehet mbi dispozitën, që është parashikimi tekstual/gjuhësor i normës.



Dispozita përbën mjetin e nevojshëm të aksesit të normës në gjykimin e gjykatës, gjykim i cili zhvillohet mbi normën, duke e krahasuar atë me përmbajtjen e parimeve dhe të standardeve kushtetuese.

15. Gjykata edhe në një vendim të mëparshëm është shprehur se “Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër, vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme [...]. Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 e Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nisur nga këto konsiderata, Gjykata çmon se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim edhe pse *de jure* në objektin e kërkesës gjykata referuese kërkon shfuqizim të normës ligjore (neni 55 i KPC-së), *de facto* argumentet i ka të orientuara vetëm mbi vendimin unifikues nr. 3/2014. Prandaj, edhe nga mënyra si e ka paraqitur gjykata referuese këtë çështje, në thelb, ajo del jashtë juridiksionit kushtetues.

17. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës, gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm nuk mund të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të

Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës.

B. Për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 32/f , të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me nenin 147/6 të Kushtetutës

18. Gjykata referuese ka kërkuar si objekt të dytë të kërkesës shfuqizimin e nenit 32/f të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: “*moszbatimi i vendimit unifikues [...] të Gjykatës së Lartë [...] përbën shkelje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit*”.

19. Sikundër më lart është pasqyruar (§10), gjykata referuese që të legjitimohet gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për antikushtetutshmëri duhet që gjatë procesit gjyqësor të përcaktojë/të identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete.

20. Në vlerësimin e Gjykatës, neni 32/f i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin gjyqësor që po zhvillohej nga gjykata referuese, pasi nga zbatimi i kësaj norme ligjore nuk do zgjidhej ose do të pengohej çështja konkrete me objekt: dëmshpërblim për arsye të shkakut të dëmit pasuror dhe jopasuror të shëndetit dhe dinjitetit.

21. Për të gjitha sa më lart, gjykata referuese nuk plotëson kriteret e legjitimitetit, në kuptim të nenit 145/2, të Kushtetutës dhe nenit 68, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145/2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.



Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë pjesërisht kundër: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, sipas interpretimit të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues administrativ nr. 3, datë 28.4.2014, si dhe i nenit 32/f, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nuk pajtohem i pjesërisht me vendimin e shumicës, lidhur me mungesën e legjitimitetit të kërkuesit për objektin e parë të kërkesës, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Në qëndrimin e saj për këtë çështje, shumica shprehet se në rastin në shqyrtim edhe pse *de jure* në objektin e kërkesës gjykata referuese kërkon shfuqizim të normës ligjore, *de facto* dyshimet i ka të orientuara vetëm mbi vendimin unifikues nr. 3/2014, të Gjykatës së Lartë. Edhe nga mënyra si e ka paraqitur gjykata referuese këtë çështje, në thelb ajo del jashtë juridiksionit kushtetues, për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës, gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm nuk mund të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2, të Kushtetutës (§16-17 të vendimit).

3. Siç është evidentuar edhe nga shumica, kërkesa në rrugë incidentale, nëpërmjet së cilës gjykatat e zakonshme kanë akses në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës

Kushtetuese, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit. Në vendimin e saj, gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që çmon se janë të papajtueshme me normat ose parimet e Kushtetutës (§9 i vendimit).

4. Po kështu gjatë jurisprudencës së saj, kur ka zhvilluar kriteret e legjitimitetit të gjykatës referuese në kontrole incidentale të normës ligjore, Gjykata ka theksuar se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t’i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në çështjen konkrete, gjykata referuese është gjendur para detyrimit për zbatim të nenit 55 të KPC-së, për të cilin ka pasur interpretim me vendim unifikues të Gjykatës së Lartë. Pra, gjykata referuese nuk ka qenë në pozicionin që të bëjë interpretime pajtuese të normës ligjore me Kushtetutën, sepse këtë funksion e ka ushtruar Gjykata e Lartë me vendimin unifikues administrativ nr. 3/2014. Në këtë situatë, gjykata referuese ka vlerësuar se mënyra si është interpretuar për t’u zbatuar neni 55 i KPC-së, nëpërmjet një vendimi unifikues, shkaktonte probleme kushtetutshmërie, prandaj i është drejtuar Gjykatës, duke kundërshtuar dispozitën përkatëse, e cila sipas saj paraqitet e vesuar nga pikëpamja kushtetuese, si pasojë e interpretimit të dhënë asaj nga Gjykata e Lartë.

6. Në rastet kur kemi të bëjmë me një kërkesë në rrugë incidentale, objekt i gjykimit kushtetues është norma, pra rregullimi juridik, dhe në rast se gjykata referuese gjendet përballë një interpretimi të dhënë me vendimin unifikues, ajo nuk mund ta ndryshojë atë duke bërë një interpretim të ndryshëm, që e konsideron të pajtueshëm me Kushtetutën, por mund të gjykojë mbi normën në kuptimin që i është dhënë nga vendimi unifikues. Nëse gjykata vlerëson se kjo normë, sipas interpretimit të dhënë nga vendimi unifikues, që



konkretizon zbatimin e saj, është e papajtueshme me Kushtetutën, ajo mund të kërkojë jokushtetutshmërinë e normës, duke u nisur nga detyrimi për të mos zbatuar asnjë dispozitë ligjore që çmohet se vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Në përputhje me këtë linjë arsyetimi, është detyrë e gjyqtarit të zakonshtëm të përcaktojë objektin dhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues (*shih dhe mendimin paralel në vendimin nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Edhe në një nga çështjet e gjykuara së fundmi nga Gjykata, lidhur me kontrollin incidental të dispozitave të interpretuara, me vendimin unifikues administrativ nr. 3/2013, të Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi nëse gjykata referuese *kishte ngritur dyshime serioze* për antikushtetutshmërinë e dispozitave ligjore si kriter legjitimimi. Ajo nuk e rrëzoi kërkesën me argumentin se kishte vendim unifikues për dispozitat objekt shqyrtimi, duke u hapur kështu rrugë kontroleve incidentale të dispozitave ligjore për të cilat ka vendime unifikuese (*shih vendimin nr. 46, datë 30.7.2014, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

8. Në rastin konkret, gjykata referuese ka argumentuar mjaftueshëm dhe ka parashtruar pretendime serioze se ndodhej para një situatë ku zgjidhja e çështjes varej nga norma, e cila, sipas kuptimit të dhënë nga vendimi unifikues administrativ nr. 3/2014, bie ndesh me disa parime dhe standarde kushtetuese. Për rrjedhojë, mendojmë se kërkuesi duhej legjitimuar për objektin e parë të kërkesës, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, dhe shumica duhej të kishte shqyrtuar themelin e pretendimeve mbi nenin 55 të KPC-së.

Anëtarë: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 27, datë 22.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

Faqe| 4710

Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.1.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 57/25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Lindita Dangëllia, Dritan Dangëllia

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Sejdin Zëre, Gjete Toma, Angjelina Toma, Drejtoria nr. 3 e Punëtorëve.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 770, datë 16.4.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ-së dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës; prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar Sejdin Zëre, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjekti i interesuar Sejdin Zëre është bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 2468,5 m², dhe i ndërtesës mbi këtë truall, me sipërfaqe 748 m², të ndodhura në rrugën “Labinoti” (*sot Rruga e Elbasanit*), me regjistrim të pronësisë në ZVRPP, Tiranë, si pasuria nr. 2/76 në ZK 8160, volumni 12, faqe 2. Ai e ka fituar këtë pronësi nëpërmjet blerjes së pjesëve të bashkëpronësisë nga trashëgimtarët e ish-pronarit Simo Simonidhi, me kontratën e shitblerjes nr. 1674 rep., nr. 119 kol., datë 20.9.2002. Subjekti i interesuar Sejdin Zëre i është drejtuar gjykatës për të kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë për kontratat e privatizimit të disa prej pasurive të paluajtshme të mësipërme, si



veprime të kryera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit që rregullon privatizimin e pasurive të paluajtshme. Në këto kontrata rezulton të jetë palë edhe Hajdar Dangëllia, trashëgimlënës i kërkuësve Lindita dhe Dritan Dangëllia.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6401, datë 18.7.2011, ka vendosur *inter alia*: “1. Pranimin e kërkesëpadisë. 2. Fshirjen nga regjistri hipotekor volumni 10, faqe 98 i ZVRPP-së, Tiranë, të regjistrimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme “truall dhe ndërtesë”, të ndodhura në rruga “Mustafa Matobiti”, nr. 1/1, Tiranë, në emër të Hajdar Dangëllisë e më pas Lindita Dangëllisë dhe Dritan Dangëllisë, si pasojë e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik kontratë shitblerje nr. 14493, rep. 4862 kol., datë 17 nëntor 1995 ... 3. Fshirjen nga regjistri hipotekor volumni 10, faqe 97 i ZVRPP-së, Tiranë, të regjistrimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme “truall dhe ndërtesë”, të ndodhura në rrugën “Mustafa Matobiti”, nr. 1, Tiranë, në emër të Melpo Toma, si pasojë e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik kontratë nr. 6417 rep. 2258 kol., datë 17 nëntor 1995 ...”

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 236, datë 1.2.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6401, datë 18.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 770, datë 16.4.2014, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit.

II

5. **Kërkuësit** Lindita Dangëllia dhe Dritan Dangëllia, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 770, datë 16.4.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për këto shkaqe:

5.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 142/1, të Kushtetutës dhe nenit 6, të KEDNJ-së në lidhje me arsyetimin e vendimit;

5.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje problemit të legjitimitetit aktiv dhe pasiv të ngritur në rekurs;

5.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të trajtonte nëpërmjet arsyetimit të vendimit cenimin e parimit të sigurisë juridike.

6. **Subjekti i interesuar** Sejdin Zëre në

parashtrimet drejtuar Gjykatës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar qëndrimin e tij si vijon:

6.1 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i marrë në dhomë këshillimi pasqyron të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuësit. Sipas këtij vendimi rezulton se gjykata ka marrë në shqyrtim jo vetëm shkakun e moslegjitimitetit të palës në ngritjen e padisë, por edhe zbatimin e gabuar të ligjit material në lidhje me cilësimin e banesave dhe të truallit objekt gjykimi si sende për të cilat nuk zbatohet ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”;

6.2 Pretendimi për moslegjitimitetin e subjektit të interesuar në ngritjen e padisë nuk hyn në sferën e juridiksionit kushtetues. Legjitimiteti i palës është një çështje e cila trajtohet nga gjykatat e faktit dhe si e tillë rezulton të jetë trajtuar prej tyre në vendimet përkatëse në të gjitha shkallët e gjykimit;

6.3 Nuk ka cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi e drejta e gëzimit ose e posedimit të sendit me qira nuk është cenuar nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar si antikushtetues, por nga ligji për kthimin dhe kompensimin pronave ish-pronarëve, i cili rivendosi të drejtën e ish-pronarëve në lidhje me pronat që iu ishin marrë në mënyrë të padrejtë nga regjimi komunist.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuësit

7. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individ, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 770, datë 16.4.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*dhomë këshillimi*).

8. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*,



Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtës kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata rithekson se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata konstaton se argumentet e kërkuësve në mbështetje të parregullsive të gjykimit në Gjykatën e Lartë lidhen me respektimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike. Në këto kushte, nisur nga natyra e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se vlerësimi i tyre përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Për cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor

11. Në çështjen në shqyrtim, kërkuësit para kësaj Gjykate kanë pretenduar se vetëm shqyrtimi i çështjes në seancë plenare dhe arsyetimi i vendimit sipas standardeve kushtetuese mund t’u jepte përgjigje problemeve të shumta ligjore të ngritura në rekurs. Gjykata e çmon të nevojshme që, në funksion të analizës së këtij pretendimi, të sqarojë fillimisht standardet kushtetuese të zbatueshme në këtë gjykim.

12. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka

theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur ose për të pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 51, datë 7.10.2014; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata, bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe jurisprudencën e saj, ka nënvizuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të



marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimin të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 51, datë 7.10.2014; nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012; nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendëse për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” [...]. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

16. Referuar standardeve të lartpërmendura, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk paraqet paqartësi dhe ndjek një linjë logjike në tërësinë e tij, duke parashtruar në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet në bazë të të cilave kërkesit kanë pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

17. Në pikëpamjen ligjore procedurale, vendimi i mospranimin të rekursit bazohet në nenin 480 të KPC-së, sipas të cilit është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në

funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

18. Nisur nga arsyetimi dhe standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesuesve, për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nuk është i bazuar.

C. Për pretendimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të trajtonte nëpërmjet arsyetimit të vendimit cenimin e parimit të sigurisë juridike

19. Kërkesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë duhet të trajtonte nëpërmjet arsyetimit të vendimit cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi banesat janë privatizuar prej tyre në vitin 1995, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kohën kur ato kanë qenë banesa shtetërore dhe pas posedimit si qiramarrës me shtetin për më shumë se 60 vjet. Sipas kërkesuesve, këto banesa nuk kanë qenë asnjëherë pronë private dhe as u janë kthyer ish-pronarëve me vendimin nr. 39, datë 5.4.2001, të KKP-së.

20. Jurisprudenca kushtetuese konceptin e sigurisë juridike të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti, i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces, ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 15.4.2014 dhe nr. 20, datë 29.9.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se në gjykimin kushtetues të kërkesave individuale, parimi i sigurisë juridike është vlerësuar në harmoni me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore



të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 12 datë 17.3.2014; nr. 7 datë 10.2.2014; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se argumentet e kërkuësve për cenimin e parimit të sigurisë juridike janë haptazi të pabazuara, për sa kohë kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit material (*legjislacionit të kthimit të pronave dhe privatizimin e pasurive të paluajtshme*), kontratave (*kontratës së shitblerjes nr. 1674/119, datë 20.9.2002, të lidhur ndërmjet subjektit të interesuar Sejdim Zëre dhe ish-pronarëve Simonidhi*), si dhe vlerësimin e akteve të tjera të administruara në gjykim. Për çështje të kësaj natyre, Gjykata Kushtetuese ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit në sferën e gjykimit të saj nuk përfshihet mënyra e zbatimit të ligjit material dhe e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për më tepër, referuar vendimeve objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se gjykatat i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “... *Palët e paditura, në kundërshtim me legjislacionin e kohës, kanë kryer privatizimin e banesave pronë private, banesa të cilat në momentin e privatizimit ishin në procedurë të rregullt shqyrtimi për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve*”. Siç rezulton edhe nga rrethanat e administruara dhe të pranuar nga gjykatat e faktit, kërkuësit e kanë fituar pronësinë mbi banesat objekt shqyrtimi gjyqësor në bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore” nëpërmjet kontratave të privatizimit të lidhura me shtetin në vitin 1995. Ndërkohë, vendimi nr. 39, datë 5.4.2001, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Tiranë, është marrë pas

shqyrtimit të kërkesës së trashëgimtarëve të ish-pronarit Simo Simonidhi, e cila është depozituar që në momentin e hapjes së dosjes nr. 1158 akti, i vitit 1994, pra përpara se të përfundonte procedura e privatizimit.

24. Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me procesin e të provuarit dhe me mënyrën e interpretimit e të zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

25. Si përfundim, duke iu referuar konkluzioneve të arritura më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka vlerësuar se pretendimi i kërkuësve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Sipas saj, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk paraqet paqartësi dhe ndjek një linjë logjike në tërësinë e



tij, duke parashtruar në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet në bazë të të cilave kërkuesit kanë pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë [...] (shih prg. 16 të vendimit). Ndërsa, për pretendimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të trajtonte nëpërmjet arsyetimit të vendimit, cenimin e parimit të sigurisë juridike, shumica ka vërejtur se argumentet e kërkuesve për këtë pretendim janë haptazi të pabazuara për sa kohë kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit material, kontratave, si dhe vlerësimin e akteve të tjera të administruara në gjykim. Sipas shumicës, gjykata i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “... palët e paditura, në kundërshtim me legjislacionin e kohës, kanë kryer privatizimin e banesave pronë private, banesa të cilat në momentin e privatizimit ishin në procedurë të rregullt shqyrtimi për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (shih prg. 22-23 të vendimit).

3. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për arsyet në vijim.

4. Siç është shprehur edhe shumica, arsyetimi i vendimeve gjyqësore është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, në përputhje me standardet e zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

5. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka nënvizuar se detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre nuk do të thotë dhënie përgjigjeje për çdo çështje/argument të ngritur nga pala për të mbështetur mbrojtjen e saj. Fushëveprimi/shtrirja e këtij detyrimi mund të

ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Për të respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, arsyetimi duhet të demonstrojë se gjyqtari/gjykata ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë ngritur përpara tij/saj (shih çështjet *Boldea kundër Rumanisë*, 15 shkurt 2007 § 29 dhe *Helle kundër Finlandës*, 19 shkurt 1997, § 60). Edhe sipas jurisprudencës kushtetuese, para së gjithash, gjykata duhet t’u japë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në proces, pavarësisht se në kuptimin kushtetues një përgjigje e detajuar nuk është në çdo rast e domosdoshme (shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese). Në kuptim të këtyre standardeve, gjykata duhet t’u japë përgjigje pretendimeve kryesore të ngritura nga pala në procesin gjyqësor, pavarësisht se nuk kërkohet përgjigje e detajuar për secilin prej tyre.

6. Në çështjen në shqyrtim si gjykata e apelit, ashtu edhe gjykata e shkallës së parë janë mbështetur në vendim në legjislacionin përkatës për privatizimin e banesave shtetërore (ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar dhe dekreti i Presidentit nr. 1440, datë 4.4.1996). Sipas këtij kuadri ligjor, banesat shtetërore privatizohen nëse nuk janë subjekt i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin pronave ish-pronarëve”. Pavarësisht këtij përjashtimi ligjor, nuk rezulton që gjykata e apelit dhe ajo e shkallës së parë të kenë verifikuar nëse banesa, objekt i shqyrtimit në themel, ka qenë pronë private.

7. Në rastin konkret kërkuesit në ankimin e paraqitur përpara gjykatës së apelit kanë kërkuar përgjigje nga gjykata për çështjet: a) nëse banesat e privatizuara prej tyre janë (ose kanë qenë) pronë private dhe si të tilla objekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve; b) nëse këto banesa pasqyrohen në aktet e pronësisë së origjinës, në aktet e shpronësimit të ish-pronarëve të viti 1947 dhe në vendimin nr. 39/2001 të KKKP-së, nëpërmjet të cilit u është kthyer prona ish-pronarëve (Simonidhëve); c) nëse këto banesa pasqyrohen në kontratën e shitblerjes së pronës apo në aktin e pronësisë së subjektit të interesuar (S.Z.).

8. Pretendimet e tyre, kërkuesit i kanë mbështetur në disa prova, si: dokumentet e origjinës së pronës, transkriptimet e kryera deri



në momentin e konfiskimit nga shteti në vitin 1947, kontratat e shitblerjes dhe dokumentet arkivore zyrtare.

9. Gjykata e apelit, në lidhje me pretendimet e mësipërme, është shprehur se “është provuar se në praktikat e privatizimit të banesave shtetërore, objekt gjykimi, Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 1 Tiranë, nuk ka verifikuar nëse kishte apo jo procedurë për njohjen dhe kthimin e pronës [...] kërkesa e ish-pronarëve për njohjen dhe për kompensimin e pronës është paraqitur në KKKP përpara se të përfundohej procedura e privatizimit [...], për sa kohë që këto banesa, referuar provave shkresore të administruara dhe aktit të ekspertimit teknik, ishin pjesë e sipërfaqes së pronës të shpronësuar ish-pronarëve (familja “Simonidhi”), Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 1 Tiranë, nuk mund të kryente asnjë veprim për privatizimin e tyre”.

10. Nga arsyetimi i mësipërm i gjykatës së apelit nuk rezulton që kjo gjykatë t’u ketë dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në ankim nga kërkuesit. Ajo u është referuar provave shkresore dhe aktit të ekspertimit teknik, por nuk ka verifikuar nëse banesa ishte pronë private apo pronë shtetërore (e ndërtuar nga shteti). Nga arsyetimi i gjykatës së apelit nuk del qartë një analizë e provave në drejtim të evidentimit të origjinës së pronësisë mbi banesën (shtetërore apo private) dhe aq më pak ndonjë konkluzion që banesa nuk ishte pronë e ndërtuar nga shteti. Megjithëse, sipas nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, barra e provës në gjykim i takonte paditësit (subjekti i interesuar) nuk rezulton që nga ky i fundit të jetë provuar se banesa ishte pronë private dhe jo pronë shtetërore. Fakti, i konstatuar nga eksperti teknik, që banesa ndodhet brenda sipërfaqes së pronës, të kthyer me vendimin nr. 39/2001 të KKKP-së ish-pronarëve, nuk provon pronësinë e këtyre të fundit mbi banesën. Detyrë e gjykatës, në këtë rast, ka qenë të vlerësonte provat, sipas kritereve ligjore, duke shpjeguar në arsyetim rezultatet e arritura provuese, mbi bazën e të cilave arrinte në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Duke mos i dhënë përgjigje pretendimit kryesor të ngritur në ankim, vlerësoj se gjykata e apelit ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e ankimit efektiv.

11. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial.

Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 10.2.2014; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009, dhe nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Cenimi i së drejtës së ankimit efektiv në rastin konkret krijon dyshime serioze për mosrespektimin e parimit të sigurisë juridike, pasi kërkuesve u janë cenuar pritshmëritë legjitime që rrjedhin nga një titull pronësie. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës. Kjo siguri presupozon, veç të tjerave, besueshmërinë e qytetarëve të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike, nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht (*shih vendimet nr. 37, datë 13.6.2012 dhe nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kërkuesit në çështjen konkrete e kanë privatizuar banesën me anë të kontratës nr. 14493, të datës 17.11.1995, dhe e kanë regjistruar këtë pasuri në regjistrat hipotekorë. Gjykata e apelit i ka privuar kërkuesit nga pronësia mbi këtë banesë pa verifikuar dhe pa u shprehur në lidhje me origjinën e pronës, duke mosrespektuar kështu garancitë që imponon parimi i sigurisë juridike.

14. Gjithashtu, megjithëse kërkuesit i kanë ngritur në rekurs të njëjtat pretendime për të cilat nuk kanë marrë përgjigje nga gjykata e apelit,



Gjykata e Lartë nuk i ka korrigjuar shkeljet e konstatuara gjatë gjykimit në apel. Prandaj vendimi i Gjykatës së Lartë është i cenueshëm, në kushtet kur është konstatuar cenim i standardit të arsyetimit, ankimit efektiv e sigurisë juridike dhe Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar vendimin e gjykatës së apelit në këto aspekte.

15. Për arsyet e mësipërme, në vlerësimin tim, Gjykata duhej të pranonte kërkesën e paraqitur nga kërkuessit dhe të shfuqizonte vendimin e gjykatës së apelit dhe vendimin e Gjykatës së Lartë.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 28, datë 22.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 12.2.2015, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 72/39 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Ylberi” sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Astrit Vata

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr. 71, datë 8.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 686, datë 25.3.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-2236 (433), datë 3.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 686, datë 25.3.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2014-2236 (433), datë 3.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe

nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuessit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuessi, si subjekt që ushtron aktivitet në fushën e kërkimeve minerare, ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të një miniere të ndodhur afër Krastës, në Bulqizë, mbi bazën e lejes minerare nr. 484, datë 2.8.1999, të miratuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë (*sot Ministria e Zhvillimit, Ekonomisë dhe Industrisë*).

2. Subjekti i interesuar është pronar i një sipërfaqeje kullote 29 313 m² në fshatin Gjon të komunës Martanesh në rrethin Bulqizë, të cilën e ka blerë nga pronari Gj.V. me kontratën e shitblerjes nr. rep.3520, nr. kol.532/2, datë 11.8.2008. Origjina e pronës në fjalë buron nga vendimi nr. 59, datë 18.8.2000, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP-ja) Bulqizë, në bazë të të cilit sipërfaqja e tokës i është kthyer ish-pronarit, që e ka regjistruar pasurinë në emër të tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë me nr. 6 hipoteke, datë 9.4.2009, nr. pasurie 703, zona kadastrale 1754, me kufizimet përkatëse.

3. Duke pretenduar se kërkuessi ka uzurpuar një pjesë të pronës së tij, duke hedhur mbetjet minerare, subjekti i interesuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me kërkesëpadi me objekt “... *Ndërprenjen e punimeve të palës së paditur brenda sipërfaqes së pronës; pushimin e cenimit të pronësisë nga pala e paditur; detyrimin e palës së paditur që t’i shpërblejë dëmin e shkaktuar në shumën 134 560 00 lekë*”. Në këtë proces gjyqësor kërkuessi ka paraqitur kundërpadi, duke kërkuar “... *pavlefshmërinë absolute dhe anulimin e vendimit të KKKP-së Bulqizë, nr 59, datë 18.8.2000; pavlefshmërinë absolute të veprimeve të regjistrimit në ZRPP të viteve 2000, 2008 dhe 2009; pavlefshmërinë e kontratës së shitjes nr. 3520 rep., nr. 532/2kol, datë*



11.8.2008, si dhe pavlefshmërinë e aktmarrëveshjes nr. 3521 rep., nr. 533/1, datë 18.8.2008”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. 71, datë 8.2.2010, ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, duke e nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor kërkimin për anulimin e vendimit të KKKP-së Bulqizë, me argumentin se “... në rastin në gjykim, pala e paditur kundërpaditëse nuk ka egzauruar ankimin administrativ tek organi më i lartë administrativ kundër vendimit të KKKP-së Bulqizë. Kemi të bëjmë me kundërshtim të një akti administrativ dhe që këto akte të kundërshtohen në rrugë gjyqësore duhet që në fillim të goditen në rrugë administrative ...”.

5. Kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, kundër vendimit të mësipërm, dhe, po ashtu, ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë kundër pranimit të padisë së paditësit.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e veçantë, me vendimin nr. 00-2010-742 (07), datë 4.5.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 71, datë 8.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për pjesën që ka vendosur të nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor kërkimin e kundërpadisë që lidhej me anulimin e vendimit të KKKP-së Bulqizë dhe dërgimin e çështjes në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit me tjetër trup gjyqësor.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 610, datë 9.11.2011, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile si një padi që nuk mund të ngrihet.

8. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 215, datë 1.3.2012, ka vendosur prishjen e vendimit civil nr. 610, datë 9.11.2011, me argumentin se referimi te neni 468 i KPC-së është kompetencë e Gjykatës së Apelit, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nisur nga vendndodhja e AKKP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5719, datë 23.5.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit. Ky vendim është bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, proces i cili, sipas vërtetimit nr. 2567 prot., datë 22.9.2014, lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë, është në proces gjykimi.

9. Për sa i përket ankimit të zakonshëm, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka marrë në

shqyrtim ankimin e paditësit, me vendimin nr. 686, datë 25.3.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 71, datë 8.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

10. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe Avokatura e Shtetit, me vendimin nr. 00-2014-2236 (433), datë 3.7.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 686, datë 25.3.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

11. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 30.9.2014, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Argumentet e parashtruara në mënyrë të përmblëdhur janë:

11.1 Është cenuar *parimi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar të vetëm, ndërkohë që padia, vlera e së cilës ishte mbi 20 milionë lekë, duhej gjykuar nga tre gjyqtarë, në referim të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja).

11.2 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, sepse gjykata, në kundërshtim me ligjin, ka vendosur nxjerrjen e disa kërtimeve të objektit të kundërpadisë jashtë juridiksionit gjyqësor, fakt i cili është konstatuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2010-742 (207), datë 4.5.2010, ka vlerësuar se vendimi gjyqësor cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

11.3 Kërkimet e padisë dhe kundërpadisë e kanë zanafillën në vendimin nr. 59, datë 18.8.2000, të KKKP-së Bulqizë, i cili nuk është vënë në diskutim gjatë gjykimit të padisë, duke qenë se ishte objekt gjykimi në një proces tjetër. Ndërkohë, kërkuesi disponon një vendim të formës së prerë, efektet e të cilit nuk mund të vihen në diskutim, dhe, po ashtu, ka ende një proces gjyqësor të papërfunduar, rezultati i të cilit është i paragjykuar si pasojë e mosgjykimit të pretendimeve njëkohësisht dhe rrëzimit të një pjese të pretendimeve.

11.4 Objekti i padisë nuk mund të ishte padia mohuese “*pushimi i cenimit të pronësisë*”, sepse kjo padi kërkon që pronari të mos jetë zhveshur nga posedimi. Ndërkohë, në rastin konkret, paditësi



nuk e ka poseduar për asnjë çast pronën e pretenduar, e cila prej 15 vitesh posedohet në mënyrë të ligjshme nga shoqëria “Ylberi” sh.p.k. Në këtë kuptim, paditësi fillimisht duhet të kërkonte anulimin e lejes minerare dhe më pas t’i drejtohej gjykatës.

11.5 Po ashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e ka gjykuar veçmas padinë, duke u shprehur në përfundim të procesit gjyqësor edhe për kundërpadinë, edhe pse ajo ka qenë objekt i një procesi tjetër, i cili ende nuk ka përfunduar. E njëjta situatë paligjshmërie ka vijuar edhe në Gjykatën e Lartë, e cila edhe pse në seancën gjyqësore të datës 13.2.2014, ka vendosur shtyrjen e gjykimit deri në dhënien e vendimit të Gjykatës së Apelit mbi objektin kryesor të kundërpadisë, në seancën e datës 3.7.2014, vijoi gjykimin dhe në përfundim u shpreh edhe për kërkimet e tjera të kundërpadisë, të cilat ishin duke u shqyrtuar në një gjykim të ndryshëm dhe si të tilla nuk mund të merreshin në shqyrtim njëkohësisht nga dy gjykata.

11.6 Kundërshtimi i titullit është padi kryesore, për këtë arsye procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë duhet të ishte pezulluar për aq kohë sa të përfundonte gjykimi mbi titullin e pronësisë. Duke qenë se kërkimet e tjera janë rrjedhojë e kërimit kryesor, gjykatat nuk mund të jepnin përgjigje në mënyrë të veçuar, pasi një procedim i tillë bie ndesh me nenin 55 të KPC-së dhe vendimet unifikuese nr. 901/2000 dhe nr. 5/2012 të Gjykatës së Lartë.

11.7 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit*, sepse gjatë gjykimit të çështjes Gjykata e Lartë ka përdorur dy standarde në lidhje me trajtimin e kërkesave të mbrojtësve të palëve për shtyrjen e gjykimit. Ndërkohë që ka pranuar kërkesën e mbrojtësit të subjektit të interesuar A.V., duke shtyrë seancën gjyqësore të datës 13.2.2014, Gjykata e Lartë ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të kërkuarit, të paraqitur në datën 3.7.2014, duke vijuar gjykimin në mungesë. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të njëanshëm ndaj kërkuarit, duke i mohuar atij të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur argumentet në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër.

11.8 Është cenuar *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, sepse gjykatat i referohen vendimit nr. 59/2000 të KKKP-së Bulqizë, ndërkohë që nuk bëjnë të ditur faktin që ky vendim është objekt i

një gjykimi tjetër të papërfunduar ende. Gjykatat pasqyrojnë fakte jo të vërteta në lidhje me lejen minerare, duke e vlerësuar atë si të përfunduar në vitin 2009, ndërkohë që nuk marrin parasysh faktin që leja është rinovuar edhe për 10 vjet, duke e shtyrë vlefshmërinë e saj në vitin 2019.

11.9 Gjykata e Lartë kishte detyrimin të mos lejonte shkelje të tilla dhe të riparonte ato që ishin kryer në Gjykatën e Apelit, duke e kthyer çështjen për rigjykim ose duke pezulluar gjykimin.

12. **Subjekti i interesuar Astrit Vata** ka prapësuar me shkrim si vijon:

12.1 Pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, pasi pala paditëse nuk e ka kundërshtuar në seancën përgatitore gjykimin e çështjes nga një gjyqtar i vetëm. Për më tepër argumentet e parashtruara nga kërkuari kanë të bëjnë me analizën e provave dhe jo me garancitë e procesit të rregull ligjor.

12.2 Edhe pretendimi për cenimin e sigurisë juridike është i pabazuar, për faktin se gjykatat e të tria shkallëve u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit dhe nuk mund të refuzonin gjykimin e padisë me argumentin se kundërpadia ishte objekt i një procesi tjetër gjyqësor.

12.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, prapësohet se ky gjykim është zhvilluar sipas rregullave të përcaktuara në nenin 481 dhe vijues të KPC-së. Për sa kohë Gjykata e Lartë u ka dhënë kohë të mjaftueshme palëve në proces, pretendimi është i pabazuar.

12.4 I pabazuar është edhe pretendimi për mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse të tria gjykatat kanë pasqyruar analizën e provave dhe të kërtimeve procedurale, duke dhënë vendime të arsyetuara.

III

Për kërkesën e pezullimit të zbatimit të vendimit gjyqësor

13. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përpara seancës mbi bazë dokumentesh, mori në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 686, datë



25.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2014-2236 (433), të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ajo vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

14. Gjykata, paraprakisht, konstaton se kërkuari është person juridik dhe si i tillë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, ai mund të jetë subjekt i të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar “*për atë që ka përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve*”, në kuptim të nenit 16, pika 2, të Kushtetutës. Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t’i atribuohen një personi juridik, për shkak të thelbit të tyre ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Për sa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në vlerësimin e legjitimitetit të personave juridikë, Gjykata bazohet në të njëjtat elemente që merren në konsideratë për legjitimitimin e individëve, në referim të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2, të Kushtetutës. Në këtë kuptim, kërkuari, shoqëria “Ylberi” sh.p.k., mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Kërkesat për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes, rregull ky i parashikuar nga neni 30, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

16. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuari i përmbush kriteret për

legjitimitimin *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se për sa i përket pretendimit se çështja duhet të gjykohej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me tri gjyqtarë, pasi vlera e padisë ishte mbi 20 milionë lekë, kërkuari nuk legjitimohet të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Ky pretendim nuk është ngritur nga kërkuari në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë, në referim të nenit 131/f të Kushtetutës, ai nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

18. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues vetëm për pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë dhe kontradiktoritetit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

19. Kërkuari ka pretenduar se gjykatat nuk mund t’i jepnin përgjigje në mënyrë të veçantë kërtimeve të padisë dhe kundërpadisë, për faktin se ato e kanë zanafillën në vendimin nr. 59, datë 18.8.2000, të KKKP-së Bulqizë. Në kushtet kur gjykatat e zakonshme i kanë vlerësuar të pabazuara kërkimet e padisë dhe për sa kohë ligjshmëria e vendimit nr. 59, datë 18.8.2000, të KKKP-së Bulqizë është ende objekt i një procesi gjyqësor të papërfunduar, rezultati i këtij procesi është i paragjykuar dhe si i tillë cenon sigurinë juridike.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).



21. Në rastin konkret Gjykata konstaton se kërkuesi, duke pretenduar pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 59/2000 të KKKP-së Bulqizë dhe anulimin e tij, ka paraqitur kundërpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Kjo e fundit ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të kërimit për pavlefshmërinë absolute të vendimit të KKKP-së Bulqizë, por pas ankimit të veçantë të ushtruar nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë dhe vlerësimit të tij si të bazuar, kërkitimi mbi kundërpadinë është bërë sërish objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër me një tjetër trup gjykues. Gjykata, po ashtu, vëren se kundërpadia është gjykuar në një proces gjyqësor të veçantë nga procesi i shqyrtimit të padisë kryesore dhe nuk ka përfunduar ende.

22. Gjykata, duke i vlerësuar rrethanat e çështjes konkrete nën dritën e qëndrimit të jurisprudencës kushtetuese mbi parimin e sigurisë juridike në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuetit nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për faktin se ai nuk ka arritur të argumentojë se në çfarë mënyre ndarja e proceseve gjyqësore dhe shqyrtimi i padisë dhe i kundërpadisë në dy procese të veçanta cenon parimin e sigurisë juridike.

23. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në procesin në Gjykatën e Lartë

24. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për faktin se Kolegji Civil nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtësit të kërkuetit për shtyrjen e seancës gjyqësore, ashtu siç ka ndodhur në rastin kur kjo kërkesë është paraqitur nga mbrojtësi i subjektit të interesuar. Për rrjedhojë, ky qëndrim i njëanshëm i Kolegjit Civil, i ka mohuar kërkuetit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur argumentet në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër.

25. Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar, sipas së cilës në procesin civil parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një

mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta, sipas kushteve të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 39, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata, referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, konkretisht procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, paraprakisht konstaton se vërehen diferenca kohore të dukshme midis tyre. Në seancën e datës 21.3.2013, Kolegji Civil ka pranuar kërkesën e administratorit të shoqërisë “Ylberi” sh.p.k. për shtyrjen e seancës, duke vendosur lajmërimin me shpallje. Seanca e radhës është zhvilluar në datën 13.2.2014, ku kërkesa për shtyrje është paraqitur nga subjekti i interesuar, e cila përsëri është pranuar nga Kolegji Civil, që ka vendosur shtyrjen e seancës dhe lajmërimin me shpallje. Në seancën e tretë të datës 3.7.2014, kërkuesi ka kërkuar përsëri shtyrjen e seancës gjyqësore me argumentin se ndodhëj në një gjykim tjetër, por Kolegji Civil, duke mos e konsideruar këtë kërkesë si shkak ligjor, ka vendosur mospranimin e saj. Në këtë seancë ka qenë i pranishëm vetëm përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit, i cili, ashtu si edhe kërkuesi, ka pretenduar prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

27. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, nisur nga karakteristikat e gjykimit në Gjykatën e Lartë sipas nenit 483 të KPC-së dhe bazuar në faktin se Kolegji Civil i ka pranuar kërkesat për shtyrje të seancave gjyqësore të paraqitura respektivisht nga mbrojtësi e palëve ndërgjyqëse, vlerëson se kërkuesi kishte pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të përjashtuar çdo shkak që mund ta pengonte atë në respektimin e detyrimit për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore. Po ashtu, duke marrë në konsideratë edhe detyrimin kushtetues të Gjykatës të Lartë për të garantuar në çdo rast zhvillimin e proceseve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuetit për cenimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si rezultat i mospranimit të kërkesës për shtyrjen e seancës gjyqësore për herë të dytë, është i pabazuar.



D. Për pretendimin e mosrespektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, pasi nuk ka pasqyruar fakte që kishin lidhje me çështjen ose i ka pasqyruar në mënyrë të shtrembëruar.

29. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në jurisprudencën kushtetuese mbizotëron qëndrimi se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht me tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese

duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe për të pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Sidoqoftë, detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshtëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me analizën e provave dhe të fakteve ku janë bazuar gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e themelit të çështjes. Nisur nga natyra ligjore e këtyre argumenteve, Gjykata çmon se vlerësimi i



tyre mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

34. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë i plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe nuk ngre dyshime mbi cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këto arsye, pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuari, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 29, datë 22.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 19.3.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUES: Llukan Simo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Bashkia Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Auberon Alexander Bernard Dru, Robert John Grant.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajftueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 238, datë 1.2.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-2523, datë 7.12.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari është pronar i një banese me sipërfaqe 79 m², e ndodhur në Tiranë, për të cilën disponon kartelë pasurie. Ai pretendon se është pronar edhe i truallit mbi të cilin vendoset kjo ndërtesë, për të cilin Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë nuk e pajis me kartelë pronësie pasi ka mbivendosje me truallin e regjistruar në pronësi të subjekteve të interesuara A.A.B.D. dhe R.J.G.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e investuar me padi nga kërkuari me objekt anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 421, datë 2.10.1995, të KKKP-së, pranë Bashkisë Tiranë [...] anulimin e vendimit nr. 122, datë 29.12.2007, të Bashkisë Tiranë për dhënien e lejes së ndërtimit [...] njohjen e paditësit si pronar i truallit prej 357 m² dhe



shtëpisë së ndërtuar mbi të, me vendimin nr. 1415, datë 28.2.2011 ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 238, datë 1.2.2012, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2523, datë 7.12.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se është cenuar e drejta e ankimit efektiv dhe e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata. Sipas kërkuesit, këto të drejta janë cenuar, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs.

6. **Subjekti i interesuar**, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë ka parashtruar se:

6.1 Prona, objekt i shqyrtimit në themel, është regjistruar në regjistrin hipotekor në emër të E.H. dhe ka qenë e administruar nga shteti pas datës 29.11.1944. Shteti nuk ka gëzuar të drejtën e pronësisë mbi tokën dhe për rrjedhojë nuk mund të kalonte në favor të kërkuesit një të drejtë që nuk e kishte vetë.

6.2 Subjektet e interesuara, A.A.B.D. dhe R.J.G., duke qenë subjekte të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës (nr. 7698/1993, *i ndryshuar*), nuk duhet të shqetësohen vazhdimisht për të drejtën e fituar të pronës. Vetë qëllimi i ligjit nr. 7698/1993, *i ndryshuar*, është që t'u jepet prioritet pronarëve për kthimin dhe kompensimin e pronës.

6.3 Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e zakonshme kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe pretendimet e tij mbi cenimin e së drejtës së pronësisë janë të pambështetura.

7. **Subjektet e interesuara**, A.A.B.D. dhe R.J.G., kanë prapësuar si vijon:

7.1 Nuk është cenuar e drejta e ankimit efektiv, pasi argumentet e paraqitura nga kërkuesi i referohen vlerësimit të provave dhe mënyrës së interpretimit të ligjit, që si të tilla janë çështje të juridiksionit të zakonshëm. Shkaqet e ngritura në rekurs janë pasqyruar në vendim dhe i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

7.2 Pretendimi i kërkuesit se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, është i pabazuar. Vetë Gjykata Kushtetuese ka pranuar se arsyetimi i kufizuar i vendimeve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi nuk e cenon të drejtën për t'u dëgjuar, për sa kohë vendimi përmban shkaqet e mospranimit të rekursit dhe janë respektuar parimet themelore të procesit civil.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e së drejtës së ankimit efektiv dhe të së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata

8. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së ankimit efektiv dhe të së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata. Sipas kërkuesit këto të drejta janë cenuar, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs, duke krijuar bindjen te kërkuesi se Gjykata e Lartë nuk i ka vlerësuar këto shkaqe.

9. Paraqitja e shkaqeve të rekursit në hyrje të vendimit është trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës si një nga pjesët përbërëse të arsyetimit të vendimit gjyqësor që jep Gjykata e Lartë. Gjykata ka nënvizuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep atyre mundësinë ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 26, datë 24.6.2013; nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa



mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe për të pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Megjithatë, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes e duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata ka vënë në dukje se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që

cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar mosparaqitjen e shkaqeve të rekursit në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, që krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesit. Ajo është shprehur se “pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor. [...] Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, krijon dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve. [...] Duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj” (*shih vendimin nr. 26, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, kërkuesi pretendon se disa prej shkaqeve të ngritura prej tij në rekurs nuk janë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit,



duke krijuar bindjen te kërkuesi se Gjykata e Lartë nuk i ka vlerësuar shkaqet e ngritura në rekurs. Më konkretisht, ai parashtron se nuk janë pasqyruar këto shkaqe: a) keqinterpretimi i nenit 12 të KPC-së dhe ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (ligji nr. 7698/1993) nga gjykatat më të ulëta në lidhje me barrën e provës për sa i përket ndërtimit/pronësisë së banesës (pika 1 e rekursit); b) keqzbatimi i nenit 11/1 të ligjit nr. 7698/1993 dhe mosshprehja në vendimin e KKKP-së të faktit se mbi truallin që kthehet ndodhet një banesë në pronësi të një personi tjetër (pika 3 e rekursit); c) referimi i gabuar i gjykatës së apelit te vendimi unifikues nr. 25, datë 28.3.2003, për sa i përket çështjes së legjitimitetit të kërkuesit (pika 4 e rekursit); ç) sendi/banesa nuk duhet të trajtohet mbi bazën e ligjit nr. 7698/1993 për kthimin e pronave, pasi ka qenë e braktisur dhe jo në pronësi të të paditurve (pika 6 e rekursit).

16. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë ka paraqitur si shkaqe të rekursit fragmente të marra verbatim/tekstualisht nga ankimi i bërë nga kërkuesi në gjykatën e apelit (*shih shkaqet e ankimit në vendimin e gjykatës së apelit f. 3-5*). Duke krahasuar shkaqet që kërkuesi ka parashtruar në rekurs me ato që janë paraqitur nga Gjykata e Lartë në pjesën hyrëse të vendimit të saj, konstatohet një mospërputhje në përmbajtje, e cila nuk mund të anashkalohet dhe që qartazi ka rezultuar nga një kopjim tekstual i shkaqeve të ankimit. Gjykata vlerëson se kjo mangësi është një e metë serioze e arsyetimit, që lë shkas për ekuivoke e dyshime në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesit nga ana e Gjykatës së Lartë. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata konkludon se mënyra e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, jo vetëm nuk përmbush kriteret minimale ligjore të arsyetimit të vendimit gjyqësor, por krijon, gjithashtu, dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së ankimit dhe të drejtës për t’u dëgjuar nga gjykata.

17. Si përfundim, në vlerësimin e Gjykatës, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv dhe të drejtës për t’u dëgjuar nga gjykata, si rrjedhojë e mosrespektimit nga

Gjykata e Lartë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,¹

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2012-2523, datë 7.12.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 62, datë 11.5.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108,

¹ Gjyqtari V. Kristo votoi për rrëzimin e kërkesës, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin e pakicës së vendimit nr. 34, datë 13.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese.



datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “b”. Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit, i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 63, datë 11.5.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGAL” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energal” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energal” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”, sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar, i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “b”, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit, i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”, nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Energal” sh.p.k., nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energal” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 64, datë 11.5.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ELECTRAL” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Electral” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Electral” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Faqe| 4728

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 65, datë 11.5.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ELECTRAL” SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; nenit 9, 45, pika 4, dhe nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Electral” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Electral” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 66, datë 11.5.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LENA 1”, “LENA 2” DHE “LENA 2A”, ME FUQI TË INSTALUAR, PÛRKATËSISHT 1.95, MW; 2.3 MW DHE 0.25 MW (FUQI TOTALE 4.5 MW)

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 8, 9 dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe

të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”;

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.1. Është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.2. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni teknik-ekonomik është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera. Është plotësuar pjesërisht.

Është në proces miratimi i pikës se lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10, dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”, me fuqi të instaluar, përkatësisht 1.95 MW, 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 67, datë 11.5.2015****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAMA
ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2, 8 dhe 10, pika 1, dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”. Është e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “b”. Është e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”. Nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 68, datë 11.5.2015****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
KUALIFIKIM IMPIANTI PRODHUESI
BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE
TË SHOQËRISË “GAMA ENERGY”
SHPK, PËR HEC “LENA 1”, “LENA 2”
DHE “LENA 2A”, PËRKATËSISHT ME
FUQI 1.95 MW, 2.3 MW DHE 0.25 MW
(FUQI TOTALE 4.5 MW)**

Në mbështetje neni 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 8 të “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikim impianti prodhues si burim i rinovueshëm energjie për HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të certifikimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:



- Është dhënë informacioni i kërkuar lidhur me klasifikimin e impiantit të ndërtuar.

- Është paraqitur raporti teknik, i cili përshkruan hollësisht teknologjinë gjeneruese që do të përdoret në impiantin e sipërpërmendur.

- Është paraqitur dokumentacioni teknik, i cili përshkruan karakteristikat bazë të të gjitha elementeve të impiantit prodhues.

- Janë paraqitur skicat e projektit të zbatimit.

- Nuk është paraqitur harta korografike e impiantit.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10, dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për kualifikim impianti prodhues të shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 69, datë 11.5.2015

MBI MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS SË ERE-S, PARASHIKUAR NË NENIN 4 TË LIGJIT NR. 119/2014, “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

Në mbështetje të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neni 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave

personale, si dhe dëgjoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Enti Rregullator i Energjisë është autoritet publik në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neni 2, pika 1, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

- Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE-s, parashikuar në neni 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për implementimin e programit të transparencës sipas këtij vendimi e lidhjeve bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 70, datë 13.5.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KACNI”, ME FUQI TOTALE 3.87 MW

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të



Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Kacni”, me fuqi totale 3.87 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në: nenin 9, pika 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pika 2 (dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor); nenin 9, pikat 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuar në nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC-in); neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni teknik-ekonomik); neni 9, pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera), është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kacni”, me fuqi totale 3.87 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 71, datë 13.5.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOXHERRI ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Koxherri Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “a” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “b” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 72, datë 13.5.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “a” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “b” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, germa “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 73, datë 13.5.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4 dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

KËRKESË

Nr. 959/1, datë 20.5.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Elbasanit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të ndërtimit të varrezave publike të qytetit, në Bashkinë e Elbasanit është 3 008 100 (tre milionë e tetë mijë e njëqind) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebre

TABELA PËRBLËDHËSE E VLERËSIMIT

TË SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME ("TOKË ARË"), PRONË PRIVATE TË CILËT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË ELBASANIT (Z.K.8522)

			Vërtetim pronësie			TOKË ARË			BANESA				NJËSI				SHPRONËSI MI			
Nr	Bashkëpronari	Nr	Pjesë	m ²		shpronësim	çmimi	shpronësim	Sip banes m ²	çmimi	shpronësi m	Sip njësisë m ²	çmimi	shpronësim	SHUMA	Vërtetim pronësie				
	që shpronësohet	Pasur		toke arë	ban	njësi	m2	lekë/m ²	lekë	preket	shpronësim	s	lekë/m ²	lekë	preket	shpronësim	2	lekë	leke	
1	Adile Kamer Dylgjeri(Sulova)	18/27	4		0.00	0.00	1850.00	271	501350.00	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	501350.00	Konfirmuar ZVRPP
2	Nashifer Kamer Shyti (Sulova)		4		0.00	0.00	1850.00	271	501350.00	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	501350.00	
3	Hismete Kamer Sulova		4		0.00	0.00	1850.00	271	501350.00	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	501350.00	
4	Naim Kamer Sulova		4		0.00	0.00	1850.00	271	501350.00	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	501350.00	
5	Fatmire Kamer Stafa (Sulova)		4		0.00	0.00	1850.00	271	501350.00	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	501350.00	
6	Kamber Ali Sulova		1.3		0.00	0.00	616.67	271	167116.62	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	167116.62	
7	Alketa Ali Dedja		1.3		0.00	0.00	616.67	271	167116.62	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	167116.62	
8	Klevis Ali Sulova		1.3		0.00	0.00	616.67	271	167116.62	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	167116.62	
Totali			24		0.00	0.00	11100.00	271	3008099.86	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3008099.86	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006